



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИСË СË

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 97-të të mbajtur më 27.12.2023, ka miratuar sa vijon,

VENDIM

Procedura sipas lëndës me numër 12-4855/1 të datës 10.11.2023, është formuar sipas denoncimit të dorëzuar për punësimin e personit fizik me orar të plot pune në dy vende pune, NDËRPRITET

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, KSHPK konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm.

Lënda me numër 12-4855/1 të datës 10.11.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Më datë 10.11.2023 është dorëzuar denoncim nga një denoncues i panjohur për punësim me kohë të plotë të një personi fizik në dy vende pune dhe është formuar lënda me numër 12-4855/1 datë 10.11.2023.

Në denoncim thuhet se ----- Myftiu -----, i cili është i punësuar si Myfti i -----, në të njëjtën kohë është profesor i rregullt në -----, pra në të dyja vendet punon me orar dhe rrogë të plotë dhe nga KSHPK-ja kërkohet që ta hetojë këtë rast nëse bëhet fjalë për keqpërdorim.

Duke marrë parasysh se i denoncuarit sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit është person zyrtar në kuptimin e marrëdhënies së tij të punës në fakultet, KSHPK-ja iu drejtua ----- për të paraqitur informacione për angazhimin/punësimin e personit ----- të universitetit, me bashkëlidhjen e akteve përkatëse për të njëjtën.

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија

Адреса: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut

email: contact@dksk.org.mk

tel/tel: +389 2 3248 930

<http://www.dksk.mk>

Një njoftim është dorëzuar nga ----- se personi i treguar është në punë me kohë të plotë në Fakultetin Filozofik në ----- dhe u zgjodh në titullin mësitor-shkencor të profesor i rregullt, dhe bashkëngjitur është vendimi për përzgjedhjen në profesionin mësitor-shkencor i marrë më 16.11.2016.

Nga ana tjetër, në periudhën pas konstatimit të lëndës në KSHPK dhe përpunimit të të njëjtit – mbledhjes së të dhënave të lartpërmendura, duke iu referuar njoftimit të BFI-së, në media është publikuar informacioni se Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame mori vendim për shkarkimin e ----- - ----- dhe lidhur me informacionet e mediave të caktuara është bërë i ditur edhe vendimi.

Duke marrë parasysh sa më sipër, KSHPK-ja, në bazë të informacioneve të disponueshme publikisht, konstatoi se gjendja e raportuar në aplikacion është tejkaluar, prandaj nuk ka elemente për veprime të mëtejshme dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti: B.K.SH

Miratoi: N.B, Anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHITETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar,
Sofka Pejovska Dojçinovska**